

UNITED NATIONS DEVELOPMENT PROGRAMME  
INSTITUTI PËR STUDIME DHE HULUMTIME JURIDIKE, FAKULTETI JURIDIK  
AGJENCIA PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS

**H U L U M T I M**

---

**Tema:** “Cilat janë përparësitë dhe mangësitë e Ndhmës Juridike Falas në Kosovë dhe si mund të përmirësohen shërbimet e Ndhmës Juridike Falas në Kosovë”

**Punoi:** Ifakete ZHUKANI

Nr. ID: 140401110023

Fakulteti Juridik, Universiteti i Prishtinës

Prishtinë, 2020

## 1. HYRJE

Ndihma juridike falas paraqet një mekanizëm përmes të cilit personave në pamundësi financiare u ofrohet shërbim juridik pa pagesë, pra u mundësohet qasje në sistemin juridik/gjyqësor, si një e drejtë themelore që garantohet me akte ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare.

Termi “ndihmë juridike falas” nënkupton të drejtën në shërbime profesionale juridike falas për qytetarët që plotësojnë kriteret e përcaktuara.<sup>1</sup> Ajo zbatohet në rastin kur personat në gjendje jo të mirë financiare kanë probleme në marrëdhëniet familjare, pronësore, punës, detyrimore, administrative, apo kanë statusin e të arrestuarit, paraburgosurit etj.

Ndihma juridike falas vlerësohet e nevojshme në Kosovë, duke pasur parasysh gjendjen jo të mirë ekonomike të popullsisë. Bazuar në të dhënat e Agjencisë Statistike të Kosovës numri i familjeve përfituese nga skema e ndihmës sociale në vitin 2019 ishte 24.352 familje.<sup>2</sup> Ky numër është i konsiderueshëm në krahasim me popullsinë e përgjithshme rezidente prej 1,782,115 banorë (viti 2019). Në anën tjetër, gjatë po këtij viti numri i lëndëve në Gjykatat e Kosovës ka qenë 360,806 që është tregues i numrit të madh të transaksioneve ligjore dhe procedurave gjyqësore që zhvillohen.<sup>3</sup>

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian po ashtu parashohin ndihmën juridike, dhe mes tyre vërehen diferenca ashtu që disa nga to praktikojnë qasje të përgjithshme ndërsa disa tjera mundësojnë ndihmë juridike vetëm për shtresat më të varfëra të popullsisë.<sup>4</sup>

Në vijim do të parashtrohen disa nga karakteristikat e ndihmës juridike në vende të ndryshme anëtare të BE.

---

<sup>1</sup> Neni 1, par. 1.1., Ligji Nr. 04/L-017 Për Ndihmë Juridike Falas

<sup>2</sup> Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës, 2020, fq. 15

<sup>3</sup> Raporti Vjetor Statistikor i Gjykatave, 2019

<sup>4</sup> [https://e-justice.europa.eu/content\\_legal\\_aid-37141-en.do](https://e-justice.europa.eu/content_legal_aid-37141-en.do)

### **Republika e Austrisë:**

- Ndhimja juridike nuk gjen zbatim në kërkesëpaditë civile në procedurën penale që zhvillohen pranë Departamentit Penal të Gjykatës por lejohet që këto kërkesëpadi të parashtrihen në të njëjtën kohë pranë Departamentit Civil;
- Pala e cila ka përfituar ndihmë juridike falas në ndonjë vend anëtarë të Bashkimit Evropian do të sigurojë ndihmën po ashtu edhe në Republikën e Austrisë lidhur me njohjen dhe përmbarimin e vendimit të marrë në procedurën e inicuar gjyqësore;
- Aplikimi për përfitimin e ndihmës juridike duhet të parashtrohet në Gjykatën e shkallës së parë, dhe ky është organi i cili vendos lidhur me përfitimin e ndihmës juridike;
- Përzgjedhja e avokatit bëhet nga Oda e Avokatëve, pas aprovimit të kërkesës nga Gjykata;
- Përzgjedhja bëhet sipas renditjes alfabetike. Parashtruesi i kërkesës mund të propozojë një avokat por që propozimi nuk ka karakter detyrues dhe përzgjedhja mund të jetë tjetër nga propozimi;
- Në rast se humbet rasti përfituesi duhet të rimbursojë shpenzimet procedurale të palës tjetër.<sup>5</sup>

### **Republika Franceze:**

- Ndhimja juridike gjen zbatim në të gjitha procedurat ligjore;
- Parashih ndihmën juridike të pjesshme e cila jepet në lartësinë prej 85%, 70%, 55%, 40%, 25% ose 15% varësisht nga statusi financiar i përfituesit;
- Aplikimi për përfitimin e ndihmës juridike falas duhet të parashtrohet në Gjykatën kompetente ose në Byronë për Ndhimë Juridike;
- Përzgjedhja e avokatit bëhet nga vetë parashtruesi i kërkesës, e në mungesë të një propozimi përzgjedhja bëhet nga gjykata kompetente.<sup>6</sup>

### **Republika e Polonisë:**

- Ndhimja juridike gjen zbatim në procedurë civile si p.sh. marrëdhënie familjare, punësimi dhe rastet sociale;

---

<sup>5</sup> [https://wayback.archive-it.org/12090/20191030183930/https://ec.europa.eu/civiljustice/legal\\_aid/legal\\_aid\\_aus\\_en.htm](https://wayback.archive-it.org/12090/20191030183930/https://ec.europa.eu/civiljustice/legal_aid/legal_aid_aus_en.htm)

<sup>6</sup> [https://wayback.archive-it.org/12090/20191030183855/https://ec.europa.eu/civiljustice/legal\\_aid/legal\\_aid\\_fra\\_en.htm](https://wayback.archive-it.org/12090/20191030183855/https://ec.europa.eu/civiljustice/legal_aid/legal_aid_fra_en.htm)

- Aplikimi për përfitimin e ndihmës juridike falas duhet të parashtrohet në Gjykatën kompetente dhe nuk parashihet formë aplikimi pra mjafton të bëhet me shkrim;
- Përzgjedhja e avokatit bëhet nga Oda e Avokatëve ndërsa përfituesi mund të propozojë avokatin dhe kërkesa vlerësohet më tej.<sup>7</sup>

Duke qenë se ndihma juridike falas gjen zbatim në sistemet juridike bashkëkohore dhe evidentohen mjaft dallime mes tyre, Republika e Kosovës mund të shërbehet me rregullativën ligjore dhe praktikën juridike të këtyre vendeve për të përmirësuar sistemin e saj.

## 2. NDIHMA JURIDIKE FALAS NË KOSOVË

Në Kosovë ndihma juridike falas parashihet me Kushtetutë e cila garanton ndihmën juridike falas për personat që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse kjo ndihmë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.<sup>8</sup> Ajo po ashtu rregullohet me Ligjin nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas (tutje “Ligji”).

Me anë të Ligjit parashihet ndihmë juridike falas në gjithë territorin e Republikës së Kosovës pa përjashtim, dhe atë në procedurën gjyqësore civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse, lidhur me informatat dhe këshillat juridike rreth procedurave ligjore, përpilimit të shkresave dhe mbështetjes administrative/teknike lidhur me kompletimin e lëndës si dhe me përfaqësimin gjyqësor.<sup>9</sup>

Sipas legjislacionit të Kosovës për të qenë përfitues i ndihmës juridike falas duhet të plotësohet kriteri *kualifikues* (ka të bëjë me personat me të drejtë përfitimi ku bëjnë pjesë shtetasit e Republikës së Kosovës me vendbanim në Kosovë, personat me qëndrim të përkohshëm, personat tjerë të përcaktuar me legjislacion apo rregullat e të drejtës ndërkombëtare dhe personat që përfitojnë në bazë të reciprocitetit), *financiar* (klasifikohet në ndihmë juridike primare dhe u dedikohet personave që janë përfitues të ndihmës sociale dhe personave në situatë të ngjashme me këta të fundit dhe ndihmë juridike sekondare e cila u dedikohet personave me të ardhura familjare

<sup>7</sup> [https://wayback.archive-it.org/12090/20191030183933/https://ec.europa.eu/civiljustice/legal\\_aid/legal\\_aid\\_pol\\_en.htm](https://wayback.archive-it.org/12090/20191030183933/https://ec.europa.eu/civiljustice/legal_aid/legal_aid_pol_en.htm)

<sup>8</sup> Neni 31 (E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm)

<sup>9</sup> Neni 4, Ligji Nr. 04/L017 Për Ndihmë Juridike Falas

më të ulëta se sa të ardhurat mesatare familjare), *juridik* (specifikat e rastit juridik siç janë vlera reale e kërkesë, fuqia argumentuese e provave dhe mundësia e suksesit të kërkesës).<sup>10</sup>

Ligji parasheh edhe ndihmën juridike falas të menjëhershme e cila ofrohet për personat e arrestuar apo ndaluar në polici, pavarësisht nëse janë përmbushur kriteret e kërkuara me ligj.

Ndihma juridike falas paraqitet e institucionalizuar falë krijimit dhe funksionimit të disa mekanizmave siç është Këshilli për Ndhmë Juridike Falas (tutje “Këshilli”) i cili zgjedhet nga Kuvendi i Kosovës dhe kryen aktivitetin në mënyrë të pavarur, dhe Agjencia për Ndhmë Juridike Falas (tutje “Agjencia”) e cila i nënshtrohet mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë nga Këshilli.

Duke qenë se ofrohet ndihma juridike falas në shtrirje territoriale në gjithë Kosovën, ajo mundësohet përmes zyrave Rajonale, zyrave mobile, avokatët dhe organizatat jo-qeveritare partnere të Agjencisë.

Procedura për përfitimin e ndihmës juridike falas inicohet përmes kërkesës bashkë me provat dhe dokumentacionin relevant dhe më pas ajo i nënshtrohet vlerësimit nga zyrtarët të cilët nxjerrin vendim për lejimin ose refuzimin e kërkesës, brenda afatit prej 5 ditëve nga dita e dorëzimit të dokumentacionit të kompletuar. Me vendim po ashtu përcaktohen shërbimet e autorizuara të cilat i komunikohen avokatit mbrojtës. Në rast të refuzimit, parashtruesi i kërkesës ka të drejtën të paraqesë Ankesë në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimin të vendimit mbi refuzimin, dhe lidhur me ankesën do të vendosë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimin të saj.

Sipas të dhënave, gjatë vitit 2018 janë zhvilluar rreth 4,924 raste të ndihmës juridike falas në tërë territorin e Republikës së Kosovës nga të cilat numri më i madh i tyre i përket procedurave administrative, përfituesve meshkuj dhe evidentohet numër dukshëm më i vogël i përfituesve nga komunitetet pakicë.<sup>11</sup>

### **3. PËRPARËSITË E NDIHMËS JURIDIKE FALAS NË KOSOVË**

Në Kosovë ndihma juridike falas rregullohet me ligj të veçantë dhe përparësia qëndron se ai parasheh krijimin e mekanizmave të veçantë, siç janë Këshilli dhe Agjencia, të cilët janë të

---

<sup>10</sup> Neni 7, Ligji Nr. 04/L-017 për Ndhmë Juridike Falas

<sup>11</sup> Raporti Vjetor 2018, Agjencia e Statistikave të Kosovës

dedikuar ekskluzivisht në ofrimin e ndihmës juridike falas, për dallim nga shtete tjera të cilat këtë detyrë ia besojnë organit gjyqësor. Rregullimi i tillë në Kosovë, pra ekzistimi i organeve të specializuara, mundëson efektivitet më të lartë në dhënien e ndihmës juridike falas.

Përparësi tjetër është ofrimi i ndihmës juridike *plotësisht* falas, për dallim nga shtete tjera të cilat parashohin edhe ndihmë juridike të pjesshme. Madje në Kosovë përfitues mund të jenë edhe personat me të ardhura familjare më të ulëta se të hyrat mesatare familjare (neni 8.3 i Ligjit). Gjithashtu si rezultat i marrëveshjes me Odën e Avokatëve të Kosovës, parashihen tarifa më të ulëta kur Avokatët angazhohen nga Agjencia.<sup>12</sup>

Krahas përparësive që janë rezultat i rregullimit ligjor, përparësi ka edhe në aspektin praktik, përkatësisht kampanjat dhe materialet informuese që janë prezantuar ndër vite, zyrat mobile etj.

#### **4. MANGËSITË E NDIHMËS JURIDIKE FALAS NË KOSOVË**

Një nga mangësitë e ndihmës juridike falas në Kosovë është mungesa e akteve ligjore sekondare me të cilin do të saktësohen çështje me rëndësi, si p.sh. në rastin e përfundimit me sukses të rastit a duhet të bëhet kthimi i mjeteve nga përfituesi, deri në çfarë lartësie dhe mbi cilat kritere vendoset ashtu që të mos çënohet interesi financiar i përfituesit.

Mangësi është edhe marrja e vendimit nga ana e Gjykatës nëse përfituesi do të paguajë shpenzimet procedurale atëherë kur humbet rastin gjyqësor.

Një nga mangësitë thelbësore është buxheti i ulët i dedikuar, ku për vitin 2020 është paraparë buxhet prej 379,588 EUR. i cili është mjaft i ulët për sigurimin e shërbimeve sa më profesionale në trajtimin e rasteve.<sup>13</sup> Po ashtu nuk gjendet ndonjë strategji (e publikuar) për tërheqjen e subvencioneve ndërkombëtare.

---

<sup>12</sup> Raporti Vjetor 2018, Agjencia e Statistikave të Kosovës, fq. 16

<sup>13</sup> Ligji Nr.07/L-014 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit me nr.07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020

## 5. PËRMIRËSIMI I SHËRBIMEVE TË NDIHMËS JURIDIKE FALAS NË KOSOVË

Në Kosovë përmirësimi i shërbimeve të ndihmës juridike falas mund të bëhet përmes këtyre veprimeve:

- **Plotësimi i infrastrukturës ligjore:** Nxjerrja e akteve nënligjore, udhëzimeve, rregulloreve etj.
- **Rritja e buxhetit:** Nga një vrojtim i thjeshtë i tregut mund të evidentohen tarifrat e konsiderueshme për ofrimin e shërbimeve ligjore krahas atyre të përcaktuara nga Oda e Avokatëve, andaj rritja e buxhetit do të mundësojë angazhimin e avokatëve me ekspertizë dhe përvojë dhe rrjedhimisht efektivitet dhe rritje të besueshmërisë të masa e gjerë. Bazuar në Raportin e Agjencisë 2018, nga vitin 2010 nga 411 raste gjyqësore ndër tjera evidentohen 26 raste që kanë përfunduar pa sukses. Po ashtu nga Raporti evidentohet se Zyrat Mobile në krahasim me Zyrat Rajonale trajtojnë numër thelbësisht më të ulët, andaj me rritjen e buxhetit mundësohet hapja e zyrave rajonale në çdo pjesë të vendit;
- **Informimi:** Ndonëse ka pasur kampanja për informim rreth ndihmës juridike falas, propozohet të krijohet strategji që ato të jenë të dedikuara dhe qasshme të rastet me asistencë sociale dhe vendet rurale;
- **Targetimi i rasteve:** Të njihet e drejta e Agjencisë që të targetojë rastet potenciale për ndihmë juridike falas përmes bashkëveprimit me organet që evidentojnë dhe trajtojnë rastet sociale, përmes informimit se kanë potencialisht të drejtën e shfrytëzimit falas të këtyre shërbimeve, si dhe të mundësohet delegimi i rasteve potenciale nga Gjykata, pasi ka raste që si pasojë e mungesës së informacionit qytetarët nuk drejtohen te Zyrat për Ndihmë Juridike Falas;
- **Procedura disiplinore:** Në rast se avokatët e angazhuar neglizhojnë apo shkaktojnë vonesa të paarsyeshme në shërbimet e ndihmës juridike falas, t'i nënshtrohen përgjegjësisë disiplinore nga Oda e Avokatëve, në përputhje me rregulloren mbi procedurën disiplinore;
- **Lirimi nga shpenzimet procedurale:** Të bëhet plotësim/ndryshimi i legjislacionit ashtu që përfituesi të lirohet edhe nga shpenzimet procedurale, dhe mos të jetë çështje për vendosje nga Gjykata, pasi *prima facie* është në kundërshtim me qëllimin e synuar me Kushtetutë dhe legjislacion.

## REFERENCAT

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës
- Ligji Nr. 04/L-017 Për Ndihmë Juridike Falas
- Raporti Vjetor 2018, Agjencia e Statistikave të Kosovës
- Raporti Vjetor Statistikor i Gjykatave, 2019
- Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2020, Agjencia e Statistikave të Kosovës
- [https://e-justice.europa.eu/content\\_legal\\_aid-37141-en.do](https://e-justice.europa.eu/content_legal_aid-37141-en.do)
- [https://e-justice.europa.eu/content\\_legal\\_aid-37141-en.do](https://e-justice.europa.eu/content_legal_aid-37141-en.do)
- [https://wayback.archive-it.org/12090/20191030183855/https://ec.europa.eu/civiljustice/legal\\_aid/legal\\_aid\\_fra\\_en.htm](https://wayback.archive-it.org/12090/20191030183855/https://ec.europa.eu/civiljustice/legal_aid/legal_aid_fra_en.htm)
- [https://wayback.archive-it.org/12090/20191030183930/https://ec.europa.eu/civiljustice/legal\\_aid/legal\\_aid\\_aus\\_en.htm](https://wayback.archive-it.org/12090/20191030183930/https://ec.europa.eu/civiljustice/legal_aid/legal_aid_aus_en.htm)
- [https://wayback.archive-it.org/12090/20191030183930/https://ec.europa.eu/civiljustice/legal\\_aid/legal\\_aid\\_aus\\_en.htm](https://wayback.archive-it.org/12090/20191030183930/https://ec.europa.eu/civiljustice/legal_aid/legal_aid_aus_en.htm)
- [https://wayback.archive-it.org/12090/20191030183933/https://ec.europa.eu/civiljustice/legal\\_aid/legal\\_aid\\_pol\\_en.htm](https://wayback.archive-it.org/12090/20191030183933/https://ec.europa.eu/civiljustice/legal_aid/legal_aid_pol_en.htm)